


Aktivitetet e inovacionit në ndërmarrje

Tiranë, më 27 Qershor 2024: INSTAT ka kryer për periudhën referuese 2020-2022 vërtetimin mbi aktivitetet e Inovacionit pranë ndërmarrjeve me 10 ose më shumë të punësuar. Ndërmarrje inovative quhet ajo ndërmarrje që gjatë periudhës referuese prezantoi një inovacion produkti/procesi biznesi, ose kishte aktivitete të braktisura apo të papërfunduara inovacioni gjatë viteve paraardhëse. Gjatë periudhës 2020-2022, 42,9 % e ndërmarrjeve të vërtetuara kryen një aktivitet Inovacioni. Krahasuar me të dhënat e vërtetimit të mëparshëm të inovacionit me periudhë referuese 2018-2020, aktiviteti i inovacionit u rrit me 6,3 % (nga 36,6 % në 42,9 %).

Fig. 1 Përqindja e ndërmarrjeve aktive në Inovacion sipas aktivitetit ekonomik, 2020-2022 (%)



Burimi: Anketa mbi inovacionin në ndërmarrje, 2020-2022

Aktiviteti i Inovacionit rezultoi më i lartë në ndërmarrjet që operojnë në sektorin e shërbimeve me 46,0 %, ku ndërmarrjet në aktivitetin e Informacionit dhe Komunikacionit kanë rezultuar aktive në Inovacion me 67,3 %, ndërmarrjet në aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit me 52,7 %, etj.

Në sektorin e Industrisë aktiviteti i Inovacionit rezultoi me 39,3 % ku ndërmarrjet në aktivitetin e Energjisë elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar kanë rezultuar aktive në Inovacion me 44,4 %, në Industrinë Përpunuese me 42,0 %, etj. (Fig.1).

Për publikim 27/06/2024

Ndërmarrjet në sektorin e industrisë shënojnë një rritje më të lartë në aktivitetin e inovacionit me 7,2 pikë përqindje ndërsa ndërmarrjet në sektorin e shërbimeve shënojnë një rritje me 5,0 pikë përqindje krahasuar me të dhënat e periudhës së mëparshme.

Aktiviteti i inovacionit rezultoi më i pranishëm në grupin e ndërmarrjeve të mëdha, me mbi 250 të punësuar me 66,5 %. (Tab.1)

Gjithashtu sipas madhësisë së ndërmarrjeve, vihet re se ndërmarrjet e vogla (10-49 të punësuar) kanë pësuar rritje të ndjeshme në aktivitetin e inovacionit me 7,4 pikë përqind rritje.

Gjatë kësaj periudhe bizneset e vogla kanë zhvilluar produkte inovative më shpejt se ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha.


Tab.1 Ndërmarrjet aktive në Inovacion sipas sektorëve ekonomikë dhe madhësisë së ndërmarrjes (%)

	Ndërmarrje aktive në Inovacion 2018-2020	Ndërmarrje aktive në Inovacion 2020-2022
Gjithsej	36,6	42,9
Aktiviteti ekonomik		
Industri	32,1	39,3
Shërbime	41,0	46,0
Madhësia e ndërmarrjes		
10-49 të punësuar	32,1	39,5
50-249 të punësuar	49,0	51,4
250+ të punësuar	68,2	66,5

Burimi: Anketa mbi inovacionin në ndërmarrje, 2020-2022

Përqindja më e lartë e ndërmarrjeve që zhvilluan inovacione produktesh, inovacione procesesh dhe inovacione produktesh dhe procesesh së bashku rezultuan në sektorin e Shërbimeve.

Fig. 2 Ndërmarrje aktive në Inovacion sipas sektorëve ekonomikë dhe llojit të Inovacionit, 2020-2022 (%)



Burimi: Anketa mbi inovacionin në ndërmarrje, 2020-2022

Në vitin 2022, shitjet neto të realizuara nga ndërmarrjet aktive në Inovacion përbënë 58,1 % shitjeve neto gjithsej të ndërmarrjeve të vrojtuar, ndërsa numri i të punësuarve në këto ndërmarrje rezultoi 53,5 % (Tab.2) dhe (Tab.3).

Krahasuar me të dhënat e vrojtimit të mëparshëm të aktivitetit të inovacionit në ndërmarrje me periudhë referuese 2018-2020, vihet re se rritja e aktiviteteve inovative në ndërmarrje, ka sjellë rritje në numrin e të punësuarve dhe shitjeve neto për ndërmarrjet që kanë rezultuar aktive në inovacion.

Shitjet neto të realizuara nga ndërmarrjet aktive në Inovacion dhe numri i të punësuarve në këto ndërmarrje janë rritur përkatësisht me 2,2 % dhe 1,6 %.

Tab. 2 Treguesit e shitjeve neto për ndërmarrjet aktive në inovacion sipas aktivitetit ekonomik, (%)

	Shitjet neto të ndërmarrjeve aktive në Inovacion (%) 2018-2020	Shitjet neto të ndërmarrjeve aktive në Inovacion (%) 2020-2022
Gjithsej	55,9	58,1
Aktiviteti ekonomik		
Industri	52,6	56,2
Shërbime	57,5	59,1

Burimi: Anketa mbi inovacionin në ndërmarrje, 2020-2022


Tab. 3 Treguesit e të punësuarve për ndërmarrjet aktive në inovacion sipas aktivitetit ekonomik, (%)

	Të punësuar në ndërmarrjet aktive në Inovacion 2018-2020	Të punësuar në ndërmarrjet aktive në Inovacion 2020-2022
Gjithsej	51,9	53,5
Aktiviteti ekonomik		
Industri	46,4	47,6
Shërbime	59,9	61,8

Burimi: Anketa mbi inovacionin në ndërmarrje, 2020-2022

Gjatë periudhës 2020-2022, 25,6 % e të gjitha ndërmarrjeve zhvilluan inovacione të produkteve (mallra ose shërbime të reja ose të përmirësuara), ndërsa 36,3 % zhvilluan procese biznesi të reja ose të përmirësuara (Fig. 3).

Fig. 3 Ndërmarrje me inovacione të produkteve dhe proceseve në biznes sipas madhësisë së ndërmarrjeve, (%)



Burimi: Anketa mbi inovacionin në ndërmarrje, 2020-2022

Gjatë periudhës 2020-2022, ndërmarrjet që zhvilluan së bashku, mallra dhe shërbime të reja ose të përmirësuara rezultuan 42,7 % të ndërmarrjeve që zhvilluan inovacion produkti .

Gjatë kësaj periudhe 44,0 % e ndërmarrjeve me Inovacione produktesh prezantuan mallra ose shërbime që ishin të reja jo vetëm për ndërmarrjen, por edhe për tregun (jo të ofruara më parë nga konkurrentët e tyre) nga 42,0 % që rezultoi në vrojtimin e mëparshëm.

Gjatë periudhës 2020-2022, 13,2 % e ndërmarrjeve aktive ne inovacion zhvilluan aktivitete të kërkim zhvillimit.

Për të kryer aktivitetin e tyre të inovacionit, 30,0 % e ndërmarrjeve aktive në Inovacion ishin të përfshirë në bashkëpunim me ndërmarrje të tjera, organizata shkencore dhe partnerë të tjerë, nga 25,9 % që rezultoi në vrojtimin e mëparshëm. Për ndërmarrjet me aktivitet ekonomik “Aktivitete profesionale, shkencore teknike” kjo përqindje rezultoi 57,7 %.

Gjatë periudhës 2020-2022, 27,9 % e ndërmarrjeve të vrojtuar kanë blerë makineri, pajisje ose mjete programuese të bazuar në teknologji të re që nuk ishte përdorur më parë nga këto ndërmarrje.

Gjatë periudhës 2020-2022, 4,3 % e ndërmarrjeve aktive në inovacion morën mbështetje financiare nga autoritetet publike nga 3,6 %, që rezultoi në vrojtimin e mëparshëm.

Ndërkohë, 1,8 % ndërmarrjeve që nuk kryen ndonjë inovacion morën mbështetje financiare publike nga 1,6 %, që rezultoi në vrojtimin e mëparshëm.

Gjatë tre viteve nga 2020 deri në 2022, 5,9 % e ndërmarrjeve aktive në inovacion kanë përdorur stimuj ose lehtësira fiskale për qëllimin e kompesimit të tatim/taksave për Kërkim dhe Zhvillim ose aktivitete të tjera inovative apo për të gjitha llojet e tjera të aktiviteteve.

Metodologjia

Vrojtimi statistikor mbi aktivitetin e inovacionit zhvillohet çdo dy vite dhe periudha e vëzhgimit e mbuluar është periudha tre-vjeçare (2020-2022). Njësitë e vëzhgimit janë të gjitha ndërmarrjet e sektorit jo-financiarë dhe financiarë me 10 ose më shumë të punësuar të angazhuar kryesisht në aktivitetet e mëposhtme ekonomike (NVE Rev. 2): Industria nxjerrëse; Industria përpunuese; Energji elektrike, uji dhe menaxhimi i mbetjeve, Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave; Transporti dhe magazinimi; Informacioni dhe komunikacioni; Aktivitetet Financiare dhe Sigurimit; Aktivitete arkitektonike dhe inxhinierike; testimi dhe analiza teknike; Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike; Publiciteti dhe kërkimet e tregut. Për matjen e aktiviteve të Inovacionit në ndërmarrje, INSTAT ka intervistuar 1,663 ndërmarrje të të gjitha formave ligjore dhe llojeve të pronësisë me 10 e më shumë të punësuar.

Përkufizime:

Një inovacion: Është një produkt ose proces i ri ose i përmirësuar (ose kombinimi i tyre) që ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga produktet ose proceset e mëparshme të njësisë dhe që është vënë në dispozicion të përdoruesve të mundshëm ose është sjellë në përdorim nga njësi.

Ndërmarrje aktive në inovacion: Një ndërmarrje e angazhuar gjatë periudhës së vëzhgimit 2020-2022 në një ose më shumë aktivitete për të zhvilluar ose prezantuar produkte të reja ose të përmirësuara ose procese biznesi për një përdorim të synuar. Gjatë periudhës së vëzhgimit mund të jenë aktive në inovacionin si ndërmarrjet novative apo ndërmarrjet jo-novative.

Një inovacion produkti: Është implementimi i një malli apo shërbimi që është i ri ose i përmirësuar dhe që ndryshon ndjeshëm nga mallrat ose shërbimet e mëparshme të ndërmarrjes. Ai përfshin ndryshime të rëndësishme të konstruktit të mallrave. Përfshihen rishitjet e thjeshta të mallrave të reja dhe ndryshimet e një natyre vetëm estetike.

Një inovacion procesi biznesi: Është një proces biznesi i ri ose i përmirësuar për një ose më shumë funksione biznesi që ndryshon ndjeshëm nga proceset e mëparshme të biznesit të ndërmarrjes dhe i cili është zbatuar brenda firmës. Inovacionet e procesit të biznesit përfshijnë metoda të reja ose të përmirësuara për: prodhimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve; shpërndarjes, furnizimit ose logjistikës; komunikimin dhe përpunimin e informacionit; kontabilitetit dhe operacioneve të tjera administrative; praktika biznesi për organizimin e procedurave ose marrëdhënieve me jashtë; organizimit të përgjegjësisë në punë, vendimmarrjes dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, marketingut për promovim, paketim, çmim, vendosje të produktit ose shërbime pas shitjes.

Inovacionet duhet të jenë të reja për ndërmarrjen në fjalë, por jo domosdoshmërisht duhet të jenë të reja në treg, d.m.th. ndërmarrja nuk ka pse të jetë domosdoshmërisht e para që ka prodhuar këto produkte (mallra ose shërbime) ose ka futur këto procese biznesi.

Aktiviteti i inovacionit: Përfshin të gjitha aktivitetet zhvillimore, financiare dhe tregtare, të ndërmarra nga një ndërmarrje, të cilat synojnë ose rezultojnë në një inovacion.

Autoritetet publike: Përfshin autoritete lokale ose rajonale, Qeverinë qendrore (ku përfshihen agjencitë e qeverisë qendrore ose ministrive), Programin Horizon 2020 për Kërkimin dhe Inovacionin dhe çdo lloj mbështetje tjetër financiare nga një institucioni i Bashkimit Europian. Mbështetja financiare publike përfshin mbështetjen financiare përmes granteve, kredive të subvencionuara dhe garancive të kredive. Përfshihet financimi i aktiviteteve nën kontratë nga sektori publik.